POSTIM ARKIVOR

# Dokumente mbi veprimtarinë e Mehdi Frashërit krijuar nga Sigurimi i Shtetit



Emërtimi i institucionit Drejtoria Zbulimit    Viti 1945
Emërtimi i sektorit Emigracioni

**D O S J A Nr. 6/1**

TITULLI I DOSJES

Dosje-fashikull me dokumenta mbi veprimtarinë armiqësore të kriminelit të luftës dhe armikut të popullit Mehdi Frashëri gjatë luftës Nac. Çlirimtare.

Afati i ruajtjes
Sasia e fletëve 75

Ka filluar më 1943
Ka mbaruar më 1944
Numuri rendor ____ i inventarit

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1943 - 1944

Mehdi Frashëri zhvilloi karrierë të gjatë në administratën shtetërore shqiptare, duke mbajtur poste ministrore të ndryshme, përfshirë Ministër i Brendshëm, Ministër i Punëve Botore, Ministër i Jashtëm, Ministër i Bujqësisë, Ministër i Drejtësisë, si dhe Kryeministër. Pas pushtimit italian në 1939 u internua, më pas mori rolin e Kryetarit të Regjencës gjatë pushtimit gjerman. Pas Luftës së Dytë Botërore, u dënua me vdekje (në mungesë) nga regjimi komunist. Dosja e Sigurimit të Shtetit dokumenton veprimtarinë e tij gjatë dhe pas Luftës, përfshirë akuzat për aktivitete kundër regjimit, përpjekjet për emigrim dhe lidhjet me grupe opozitare, përfshirë Komitetin Qendror në Kajro me figura si Ahmet Zogu.

PERMBAJTJE #1

# Dosja Mehdi Frashëri, dokumente arkivore për herë të parë për publikun

Publikohen disa dokumente të përzgjedhura nga dosja arkivore mbi veprimtarinë politike dhe historike të Mehdi Frashërit, të cilat hedhin dritë mbi një periudhë të ndërlikuar të historisë shqiptare gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Dosja përmban: ªTelegram nga Adolf Hitler drejtuar Kryetarit të Këshillit të Regjencës dhe Mehdi Frashërit ªRaporte mbi arratisjen e figurave politike shqiptare drejt Egjiptit ªInformata mbi kontaktet politike dhe përpjekjet për formimin e një qeverie shqiptare në mërgim ªShkresa për sigurimin e udhëtimeve gjatë okupacionit gjerman ªBiografi arkivore dhe materiale mbi aktivitetin politik ªDokumente mbi ndarjen nga jeta dhe varrimin ª Foto origjinale dhe dëshmi letrare kushtuar figurës së tij Këto dokumente paraqesin n jë panoramë të zhvillimeve politike, diplomatike dhe shoqërore të kohës, duke ofruar një burim të vyer për studiuesit dhe publikun e gjerë.

MEDIA #1

# Ahmet Zogu shtron darkë mbi planin për formimin e një qeverie shqipare.

MEDIA FAQE #1



INFORMATA MBI T'ARRATISURIT JASHT SHTETIT.-

Ahmet Zogu: Ne darken qe shtroj per nder te Mehdi Frasherit Xhafer Deves, Xhemal Mitrovices dhe Hiqmet Delvines. Keta te fundit me te mbrijtur nga Italija ne Kajro u takuan me Zogun. Ne darken qe Zogu shtroj, merrnin pjese dhe nji numur i madh nga autoritetet e vendit, nder te cilet: Sekretari i Pergjithshem i Legates Arabe Azzan Pasha, nen sekretari i Shtetit per punet e jashtme Kemal Abdyrrahmani Bej, Shef i Kabinetit mbreteror Ibrahim Abdel Hedi, Kryetari Organizates "Vllazerit Myslimane" Sheh El Bana, Princ Amr Ibrahimi, Sir Walter A. Smart, Minister fuqiplot prane ambasades Britanike ne Kajro dhe mjafte te tjere. Gjith'ashtu me perjashtim te Baz Kupit ishin dhe gjith besniket e Zogut.-

Te nesermen e darkes u hap fjala ne Shqiptaret e atjeshme se se shpejti do te formohet nje qeveri Shqiptare e perbere prej Ballit dhe Legalitetit me qender ne Kajro. Keto fjale duallen nga Kapiten Halil Isufi, i cili tha se ne mbremjen qe dha Zogu ishte biseduar ceshtja e formimit te Qeveris dhe se Mehdi Frasheri ka ardhur ne Kajro apostafat per kete gje. Keto fjale vazhduan te fliteshin ne Kajro per disa dite dhe opinioni ishte se pritesh te shpallesh nga casti ne cast.-

Me daten 20-2-948, po i njejti njeri tha se qeveria do te shpallte me nji here mbasi te kethehet Zogu nga Londra, dhe mbasi te kene ardhur ato te Ballit nga Italija dhe Muharrem Bajraktari nga Greqija.-

------0----

U shtyp ne 7 kopje.-

Ahmet Zogu shtron darkë mbi planin për formimin e një qeverie shqipare.

INFORMACION

## Ahmet Zogu shtron darkë mbi planin për formimin e një qeverie shqipare.

| | |
|---|---|
| FONDI | Drejtoria Zbulimit, sektori Emigracioni |
| VITET EKSTREME | 1943-1944 |
| SASIA E FLETËVE | 90 faqe |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Fashikull |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Informatë nxjerrë nga Raporti i Egjiptit datë 24.03.1949

MEDIA FAQE #1



INFORMATA MBI T'ARRATISURIT JASHT SHTETIT.-

Me rastin e nje mledhjeje,u formua nji Komitet per Kshillim, i cili ka si detyre te meret vesh sa me shpejt me te gjith Shqiptaret jashte Atdheut,te grumbulloje keto rreth tij dhe te pregatite kondi-tat per formimin e nje geverie.Ne krye te ketij Komiteti qendronte ve-te Zogu.Komiteti perbehej nga Mehdi Frasheri,si indipedent,Musa Juka, Hiqmet Delvina,Sotir Martini,Gago Gogo,Abas Kupi,Qemal Mesareja dhe Ngarem Zelhai si perfaqesonjes te Legalitetit dhe Mit-hat Frasheri, Ali Keloyra,Qasim Prodani,Rakip Frasher' dhe disa te tjera si delegat te Ballit Kombtar.Nga ana e Ballit u [illegible] vesh Ali Keloyra me rastin e takimit t[illegible] tij me Ballin.Thuhej se ne Komitet figuronin edhe Muharem Bajrakteri,Preng Previsi dhe Hamit Matjani,por kjo jo aqe e sigurte, mbasi nuk shkoje njeri nga Gregia dhe Faik Kimesi,i cili ishte derguar ne Greqi por deri [illegible] atehere nuk ishte kthyer.Gjith'ashtu ne kete mledhje u bisedua per shkrirjen e dy partive [illegible] nje parti te vetme nen emrin Indipedente,por nuk u arijte ndonji perfundim dhe u lane sa te shkonin dhe delegatet [illegible] Italia dhe Greqia.Ne Komitet ishte dhe Xhafer Deva,i cili me nji here mbas mledhjes shkoj ne Turqi.Ne kete dite pritej te kthehej prape Ernest Koliqi,i cili nji muaj me pare shkoj n'Itali.-

------0 -----

Nxjere nga reporti Egjyptit
Nr.11 date 24-3-949.-
U shtyp ne 10 kopje.-

Informatë nxjerrë nga Raporti i Egjiptit datë 24.03.1949

INFORMACION

## Informatë nxjerrë nga Raporti i Egjiptit datë 24.03.1949

| | |
|---|---|
| STRUKTURA | Drejtoria e zbulimit, sektori Emigracioni |
| VITET EKSTREME | 1943-1944 |
| NUMRI I FAQEVE | 90 faqe |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | fashikull |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Korrespondencë e Mehdi Frashërit për Patër Anton Harapi dhe Caf Alibegaj Ulqini

MEDIA FAQE #1



KESHILLI I NALTE
KRYETARI

Tiranë,me 9.X.1944

Shkëlqesis së Tyne
Pater Anton Harapi dhe Caf Alibegaj Ulqini

S-h k o d ë r

Këtu ngjitun ju dërgohet kopja e shkresës Nr.128 datë 5 Tetuer 1944 e Kryesis së Parlamentit me anën e të cilës çfaqet nevoja e ndodhjes s'Uaj në Tiranë për arsyet e ꞩregueme po në këtë shkresë.

Kemi biseduar me autoritetet Gjermane për t'Ju vënë në di pozicion një autokolonë ushtarake për sigurimin e udhëtimit të Shkëlqesis s'Uaj.

Pritni falenderimet e përzemërta të kolegve të Zotnis s'Uej.

Mehdi Frasheri
Mehdi Frashëri

AIDSSH
Nr 67 Prot Date 29.01.2026

Korrespondencë e Mehdi Frashërit për Patër Anton Harapi dhe Caf Alibegaj Ulqini

INFORMACION

## Korrespondencë e Mehdi Frashërit për Patër Anton Harapi dhe Caf Alibegaj Ulqini

| | |
|---|---|
| FONDI | Drejtoria e zbulimit, sektori emigrimit |
| VITET EKSTREME | 1943-1944 |
| NUMRI I FAQEVE | 90 faqe |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Teper sekret |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Biografia e Mehdi Frashërit

MEDIA FAQE #1



Biografi e shkurter e
MEHDI FRASHERIT .

10/45

Mehdi Frasheri, i biri Rakip bej Frasherit nga Frasheri Permetit lindur me 1872 ne Frasher dhe banues ne vende te ndryshme.

Gjate regjimit te Zogut ka qene per nje kohe Kryeminister. Pastaj eshte emeruar si perfaqesues i Shqiperise pran Lidhjes se Kombeve ku vinte ne kohen qe mblidhej ajo.

Gjate okupacionit nazist ka qene ne Shqiperi me pergjegjesi si Kryetar i Keshillit Nalte,Ky ka qene perkrahes dhe bashkepunetor me i ngushte me gjermenet,te cilet i ka quajtur si shpetimtar,mbrojtes te lirise dhe te pamvaresis se Shqiperise.Ka qene ne lidhje te drejte per drejte me Hitlerin dhe me Komandantin e forcave gjermane qe kishin zaptuar vendin tone.Duke qene ne krye te keshillit nalte ka sanksionuar te gjitha masakrat dhe raprezaliet qe i beheshin popullit tone.Ka qene armik kryesor i Levizjes Nacional Çlirimtare.Ka grumbulluar te gjithe reaksionin e vendit dhe i ka drejtuar per te shtypur luften e popullit qe bente per liri.

Ne postin e tij si kryetar i keshillit nalte ka qendruar deri ne pragun e çlirimit te Shqiperise dhe kur e pa se nuk ishte e mundur te qendronte ne fuqi as me ndihmat e forcave gjermane, u-largua per jashte shtetit ku ndodhet edhe sot.

16-X-1956

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Biografia e Mehdi Frashërit

INFORMACION

## Biografia e Mehdi Frashërit

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Ndërron jetë Mehdi Frashëri

MEDIA FAQE #1



**I N F O R M A T E:**

Me daten 25 maj 1963 ka vdekur Mehdi Frasheri, te cilin e kane varresur me daten 29/V/1963.

Burimi: "Z"

P.Op.(Xh.Hedo) dt.12/VI/963

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Ndërron jetë Mehdi Frashëri

INFORMACION

## Ndërron jetë Mehdi Frashëri

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Mehdi Frashëri

MEDIA FAQE #1



Mehdi Frashëri

INFORMACION

## Mehdi Frashëri

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Vjershë për Mehdi Frashërin

MEDIA FAQE #1



Shkëlqesisë Tij.

Krye-ministrit.

Mehdi Bej Frashërit.

Tiranë.

=Vjershë=

Gëzoju moj shqipëri
An-embanë në dëfrim
Se kryeministri iri
Krejt të ka dhënë një shkëlqim

Përpiqet si valët e detit
Që tund veporë e gjimon
Besniku i N.M.Tij Mbretit
Pa kursyerë shpirtin punon.

Je një vënd i bukur me vlerë
Se ke brënda shumë thesarë
Trima me famë ke nxjerrë
Si ata të shekullit parë.

E nderon dhe toka rrugës kur shk
Se veprat e tija shumë të rralla
Edhe gjithë bota i lavdëron
Jo me mburrje e përralla

Që i përmënd dhe historija
Me radhë gjithë sa kanë qënë
Që ika pasur shqipërija
Që u përpoqnë për at-dhenë.

Po me vepra eme shënime
Jetë shkrimi itija shumë i lartë
Përmbledh mburrje e lavdërime
Rreth trupit tija te artë.

Frashër burim i bekuarë
Që ke nxjerrë burra trima
Për kombin kanë lëftuarë
Me zëmër posi vetëtima.

Pse në çdo vënd që ay ka shkruarë
E kanë mbush me dekorata
Shtetin e tija e ka nderuarë
Duke mburur si qe pret shpata.

Që shqipëria e skllavëruarë
Prej shumë kohësh ne rrobëri
Armiqtë e poshtërm e kishin zaptuarë
Ata lëftonin për liri.

Ashtë i lumtur shteti i ynë
Sa as kush tjetër sja shkon
Shum të çelur e ka synë
Dhe gjithë bota e lavdërojnë.

Kurë vehten se kursyenë
Dhe as gjë nuk mejtonin
Por shpejt armët i rrëmbyenë
Që armikët ti dëbonin.

Kur ka të tillë trima që punojnë
Me vlerë të lartë e lavdërime
Shteti kurrë sduhet të mejtonjë
Po të lozë të qeshë plot dëfrim

Fama e tyre është e pa vdekur
Në sa shekuj që të ndërrohen
Se për at-dhenë janë përpjekur
Prandaj kurrë nuk harrohen.

Se janë lulet e arta të regjimit
Dhe lavdërimet i kanë me barrë
Po përpiqen për përparimin
Që ja u ka ngarku Zogut Parë.

Edhe sot ka na ata trima
Që përpiqen kurrë spërtojnë
Burra drangoj si vetëtima
Si e si shtetin ta lartësojnë.

Vrejnë shumë e spërtojnë
Po i kanë rënë pas aktivitetit
Dhe me kujdesi të madhe veprojnë
Urdhënat e N. M. Tij Mbretit.

Nat e ditë me penë në duar
Etu mendu kurrë spërtojnë
Shtetin e dashur për të përparuarë
Që gjithë bota ti lavdërojnë.

Dhe duke përpjekur me shumë mendime
Shtetin e dashur e kanë lartësuarë
Kanë dhënë fruta e zbukurime
Si e shikoni që e kanë ndriçuarë.

Mehdi Beu porsi dragua
Mëndja e pena e lartëson
Kurr as njëherë sashtë përtuarë
Prandaj gjithë shteti e lavdëron.

Pra të rronjë etë mbretëronjë
Shteti dashtun me Shqiptarë
Dhe gjithë atë që ndëgjojnë
Urdhënat e nalta të N. M. Tij Z.I.

Fund.

Me përunjësi

Bindje dhe respekte shesnikëri ushtarake.

Hajrulla N. Erseka.

AIDSSH

Vjershë për Mehdi Frashërin

INFORMACION

## Vjershë për Mehdi Frashërin

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

# Telegram nga Adolf Hitler

MEDIA FAQE #1



Telegram

Shkelqesis së Tij
Kryetarit të Këshillit të Regjencës
Zotit Mehdi Frashëri

Tiranë

Shkelqesi

Ju falënderoj sinqerisht për urimet miqësore, të cilat Ju me kini dërgue telegrafisht në emën të Anëtarvet të Këshillit të Regjencës sidhe në emnin Tuej me rasë të atentatit të drejtuem kundrejt meje.

Adolf Hitler

KRYESIA E KËSHILLIT TË NALTË
Mbrrijtun më 9 - 8 -1944
Nr. -1235 Dosja KN.

Nº ARSHIVË

8.8.944

AMSSH ProtDate 29.01.2026

Telegram nga Adolf Hitler

## INFORMACION

## Telegram nga Adolf Hitler

## TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.